



Raporti i Parë i Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit

Hekurudha Shqiptare
Projekti i BERZH-it numër 48466
Rasti 2023/02

Shkurt 2024

Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin (IPAM) është mekanizmi i llogaridhënies i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). IPAM-i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet që individët ose organizatat ngrenë lidhur me Projektet e financuara nga Banka, për të cilat mendohet se kanë shkaktuar, ose kanë të ngjarë të shkaktojnë dëme. Qëllimi i Mekanizmit është të lehtësojë zgjidhjen e çështjeve sociale, mjedisore dhe të dhënies së informacionit me palët e interesit të projektit; të përcaktojë nëse Banka ka vepruar në pajtueshmëri me Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale ose dispozitat specifike për projektin të Politikës së Aksesit në Informacion; si dhe, kur është e mundur, të trajtojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar çdo papajtueshmëri nga ana e Bankës në të ardhmen. Për informacione të mëtejshme rreth IPAM-it, na kontaktoni ose vizitoni www.ebrd.com/project-finance/ipam.html

Informacioni i kontaktit Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies së Projektit Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim Five Bank Street Londër E14 4BG Telefon: +44 (0)20 7338 6000 Email: ipam@ebrd.com	Si të paraqisni ankesë në IPAM Shqetësimet lidhur me performancën mjedisore dhe sociale të një Projekti të BERZH-it mund të paraqiten nëpërmjet e-mail-it, postës ose formularit <i>online</i> në adresën: https://www.ebrd.com/project-finance/ipam.html
--	--

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
1. KONTEKSTI.....	6
1.1. Kërkesa	6
1.2. Projekti	6
2. NISMA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT	7
3. MONITORIMI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT	7
3.1. Veprimtaritë e Monitorimit.....	8
3.2. Statusi i zbatimit të Marrëveshjes	8
4. PËRFUNDIMI.....	8

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë raport janë të njëjtë me ata të përcaktuar në Politikën e Llogaridhënies për Projektin 2019.

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtimi	Forma e gjatë
Bordi	Bordi Drejtues i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Rast	shqyrtimi i një Kërkese sipas Politikës së Llogaridhënies për Projektin pas regjistrimit
CAO	Drejtori i Përgjithshëm i Llogaridhënies i BERZH-it, dhe kreu i IPAM-it
Regjistri i Rasteve	Regjistri i Rasteve krijuar në përputhje me Seksionin III, Pikën 3.1 të Politikës së Llogaridhënies për Projektin, që mund të gjendet në faqen e internetit të IPAM-it
Përputhshmëria	funksion i IPAM-it, që përcakton nëse BERZH-i ka vepruar në pajtueshmëri me Politikën Mjedisore dhe Sociale ose me dispozitat specifike për projektin të Politikës së Aksesit në Informacion, në kuadër të një Projekti të caktuar
BERZH (ose Banka)	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
PMS	Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it në fuqi në kohën e miratimit të Projektit
IPAM	Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin i BERZH-it, i krijuar në përputhje me Politikën e Llogaridhënies për Projektin 2019
Kreu i IPAM-it	drejtori menaxhues i BERZH-it, përgjegjës për funksionimin e IPAM-it, zbatimin e Politikës së Llogaridhënies për Projektin dhe marrjen e vendimeve që janë në kompetencën e IPAM-it sipas kësaj Politike
PLIP	Politika e Llogaridhënies për Projektin 2019
Palët	individët, entitetet dhe/ose organizatat që kanë interes të drejtpërdrejtë në një Rast. Palët mund të përfshijnë (por nuk kufizohen te): Kërkuesit; Përfaqësuesit e tyre, nëse kanë; departamentin, ekipin ose njësinë përkatëse të Bankës; Klientin; dhe financuesit e Projektit ose entitetet e tjera që janë përgjegjëse për zbatimin e një Projekti
Zgjidhja e Problemit	funksion i IPAM-it, që mbështet zgjidhjen vullnetare të mosmarrëveshjeve midis Kërkuesve dhe Klientëve, për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe ato që lidhen me dhënien publike të informacionit, të parashtruara në një Kërkese, pa fajësuar askënd.
DPP	Dokumenti Përmbledhës i Projektit
Presidenti	Presidenti i BERZH-it

Përmbledhje ekzekutive

Në datën 15 dhjetor 2022, [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Z. Ditmir Zeqa, përfaqësues i 60 individëve (Kërkuesit) banues në komunitetin e Bërxullës, Bashkia Vorë, Shqipëri, lidhur me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) të financuar nga BERZH-i. Kërkuesit pretendonin se do të humbitnin aksesin te bizneset dhe banesat e tyre, si dhe te kisha e zonës për shkak se kalimi në nivel i hekurudhës, që përdorin aktualisht, do të mbyllej duke qenë se korridori i hekurudhës do të rrethohej. Megjithatë janë në dijeni se Projekti ka marrë parasysh krijimin e një kalimi automjetesh disa kilometra më tej, ata e konsiderojnë këtë kalim shumë larg për këmbësorët dhe u shprehën se rrugët lidhëse janë të papërshtatshme për automjetet e tonazhit të rëndë. Kërkuesit iu drejtuan Zgjidhjes së Problemit për trajtimin e shqetësimeve të tyre.

IPAM-i e regjistroi Kërkesën më 6 shkurt 2023 si [Rasti 2023/02](#) dhe filloi fazën e Vlerësimit, që zgjati deri në fund të muajit qershor 2023. Si pjesë e fazës së [Vlerësimit](#), IPAM-i vizitoi vendndodhjen e Projektit në Shqipëri gjatë datave 3-6 prill 2023 dhe u takua nga afër me Hekurudhën Shqiptare (Klienti), Kërkuesit dhe ekipin e projektit të BERZH-it në Tiranë për të kuptuar më mirë Projektin dhe problematikat e parashtruara në Kërkesë. Gjithashtu, IPAM-i u takua me Kryetarin e Bashkisë Vorë, Kryetarin e Njësisë Administrative Bërxullë dhe hoxhën e xhamisë së zonës. Në fund të fazës së Vlerësimit, IPAM-i konfirmoi se Klienti ishte duke punuar për gjetjen e një zgjidhjeje teknike për t'i mundësuar akses komunitetit. Palët i kërkuan IPAM-it që t'i ndihmonte të nënshkruanin një Marrëveshje për zgjidhjen e identifikuar dhe të monitoronte zbatimin e saj.

[Nisma për Zgjidhjen e Problemit](#) u ndërmor nga IPAM-i në korrik të 2023-shit dhe fokusohej te sigurimi se zgjidhja teknike e propozuar nga Klienti do të trajtojë nevojat e Kërkuesve lidhur me aksesin e këmbësorëve dhe automjeteve, që do të zëvendësojë kalimin në nivel që përdorin aktualisht. Gjithashtu, Kërkuesit kanë kërkuar t'u garantohet se kalimi aktual në nivel do të qëndrojë i hapur deri në vendosjen në funksion të zgjidhjes teknike. Nga ana tjetër, Klienti i ka kërkuar komunitetit që të lejojë vijimin e punimeve ndërtimore.

Më 26 korrik 2023, IPAM-i mbajti një takim të përbashkët me Palët në Bërxullë, gjatë të cilit u nënshkrua Marrëveshja. Palët ranë dakord edhe që kushtet e Marrëveshjes do të mbahen konfidenciale dhe se IPAM-i do të monitorojë zbatimin e saj. Më pas, Rasti u transferua në fazën e Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit.

Ky është Raporti i parë i Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit lidhur me zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit për periudhën gusht 2023 - janar 2024. Gjatë kësaj periudhe, IPAM-i komunikoi me Palët për t'u njohur me qëndrimet dhe shqetësimet e tyre, shqyrtoi përditësimet dhe dokumentacionin e dorëzuar prej tyre dhe ndërmjetësoi rrjedhën e informacionit ndërmjet Palëve.

Gjatë periudhës në fjalë, Klienti ka ndërmarrë disa hapa administrativë për të siguruar sipërfaqen e tokës të nevojshme për rrugën ndihmëse. Ky proces ka zgjatur përtej parashikimit fillestar, ndaj afati kohor për përfundimin e veprimeve të dakorduara u shty deri në muajin dhjetor 2024. IPAM-i vlerëson fleksibilitetin e Palëve dhe gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në kuadër të zbatimit të zgjidhjes dhe dëshiron t'i falënderojë të gjithë për qasjen e tyre bashkëpunuese.

Raporti përfshin një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve monitoruese të IPAM-it dhe statusin e zbatimit të Marrëveshjes. Versioni paraprak i Raportit u shpërnda me Palët dhe IPAM-i mori në konsideratë komentet e tyre gjatë finalizimit të tij. Raporti i është dorëzuar për arsye informacioni Bordit Drejtues të BERZH-it dhe Kryetari dhe Palët janë njoftuar për përfshirjen e tij në dosjen virtuale të [Rastit 2023/02](#) në gjuhën angleze dhe shqipe.

IPAM-i do të vijojë të monitorojë zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit deri në përmbylljen efektive të të gjitha angazhimeve të ndërmarra nga Palët. Raporti i dytë i Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit do të mbulojë periudhën shkurt - korrik 2024 dhe pritet të dalë në muajin gusht 2024.

1. KONTEKSTI

1.1. KËRKESA

Në datën 15 dhjetor 2022, [Mekanizmi i Pavarur i Llogaridhënies për Projektin](#) (IPAM) mori një [Kërkesë](#) nga Z. Ditmir Zeqa, përfaqësues i 60 individëve (Kërkuesit) banues në komunitetin e Bërxullës, Bashkia Vorë, Shqipëri, lidhur me [Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) të financuar nga BERZH-i. Kërkuesit pretendonin se do të humbitnin aksesin te bizneset dhe banesat e tyre, si dhe te kisha e zonës për shkak se kalimi në nivel i hekurudhës, që përdorin aktualisht, do të mbyllej duke qenë se korridori i hekurudhës do të rrethohej. Megjithëse janë në dijeni se Projekti ka marrë parasysh krijimin e një kalimi automjetesh disa kilometra më tej, ata e konsiderojnë këtë kalim shumë larg për këmbësorët dhe u shprehën se rrugët lidhëse janë të papërshtatshme për automjetet e tonazhit të rëndë. Kërkuesit iu drejtuan Zgjidhjes së Problemit për trajtimin e shqetësimeve të tyre.


IPAM-i e regjistroi Kërkesën më 6 shkurt 2023 si [Rasti 2023/02](#) dhe filloi fazën e Vlerësimit. Si pjesë e kësaj faze, IPAM-i vizitoi vendndodhjen e Projektit në Shqipëri gjatë datave 3-6 prill 2023 dhe u takua nga afër me Hekurudhën Shqiptare, Kërkuesit dhe ekipin e projektit të BERZH-it në Tiranë për të kuptuar më mirë Projektin dhe problematikat e parashtruara në Kërkesë. Gjithashtu, IPAM-i u takua me Kryetarin e Bashkisë Vorë, Kryetarin e Njesisë Administrative Bërxullë dhe hoxhën e xhamisë së zonës. Në fund të fazës së Vlerësimit, IPAM-i konfirmoi se Klienti ishte duke punuar për gjetjen e një zgjidhjeje teknike për t'i mundësuar akses komunitetit. Palët i kërkuan IPAM-it që t'i ndihmonte të nënshkruanin një Marrëveshje për zgjidhjen e identifikuar dhe të monitoronte zbatimin e saj.

1.2. PROJEKTI

[Projektin e Hekurudhës Shqiptare](#) (OP ID 48466) është një hua sovrane në vlerën 36.87 milionë euro për Republikën e Shqipërisë dhe zbatohet nga Hekurudha Shqiptare. Projekti synon rehabilitimin e linjës hekurudhore ekzistuese me gjatësi 34.17 km ndërmjet qytetit të Tiranës dhe Durrësit, dhe ndërtimin e një segmenti hekurudhor të ri prej thuajse 5 km për të lidhur linjën hekurudhore ekzistuese Tiranë-Durrës me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe njëjën me linjën ekzistuese.

Projekti u miratua nga Bordi i BERZH-it më 30 nëntor 2016 dhe u klasifikua si i kategorisë B në kuadër të Politikës Mjedisore dhe Sociale 2014 të Bankës. Sipas [Dokumentit Përmbledhës të Projektit](#), Projekti do të përfshijë çështje mjedisore dhe sociale konkrete, kryesisht për shkak të rrethimit të korridorit hekurudhor dhe mbylljes së disa kalimeve të përdorura aktualisht nga komunitetet përgjatë hekurudhës.

Linja hekurudhore Tiranë-Durrës që do të rehabilitohet (vija e kuqe), lidhja e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (vija blu)



Burimi: Kuadri i Blerjes së Tokës për Projektin e Hekurudhës Shqiptare

2. NISMA PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMIT

Funksioni i Zgjidhjes së Problemit i IPAM-it, që mbështet dialogun midis Kërkuesve dhe Klientëve, për të zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe ato lidhur me dhënien e informacionit që kanë të bëjnë me kërkesën, pa fajësuar askënd. IPAM-i angazhohet me personat e prekur nga projekti, Klientët dhe palët e tjera të interesit, si palë e tretë neutrale, për të gjetur zgjidhje të kënaqshme për të gjitha palët nëpërmjet qasjeve elastike të zgjidhjes së problemeve të bazuara në konsensus.

Gjatë fazës së Vlerësimit, IPAM-i filloi hartimin e procesit të Zgjidhjes së Problemit për [Rastin 2023/02](#). Për procesin e hartimit u morën parasysh konsideratat vijuese: Klienti kishte gjetur një zgjidhje teknike për trajtimin e shqetësimeve të parashtruara në Kërkesë, duke propozuar ndërtimin e një rruge ndihmëse paralel me hekurudhën në kalimin më të afërt në nivel; afati kohor për finalizimin e Projektit ishte i shkurtër dhe zgjidhja kërkonte pjesëmarrjen e Palëve të treta.

Për të garantuar suksesin e procesit, IPAM-it iu desh të përfshinte të gjitha palët e interesit të Projektit, që nevojiteshin për të siguruar suksesin e tij. Dy Palët kryesore në procesin e Zgjidhjes së Problemit ishin Kërkuesit, nën drejtimin e Përfaqësuesit të tyre, Z. Ditmir Zeqa, dhe Klienti i BERZH-it, Hekurudha Shqiptare, operatori i sistemit hekurudhor përgjegjës për infrastrukturën hekurudhore dhe operimin e trenave.

Krahas Palëve kryesore, aktorët e mëposhtëm u konsideruan themelorë për zgjidhjen efektive të shqetësimeve: Bashkia Vorë, ku banojnë dhe punojnë Kërkuesit, Administratori i Bërxullës përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të çështjeve të komunitetit, Kontraktori përgjegjës për rehabilitimin e hekurudhës dhe Mbikëqyrësi i Ndërtimit. Megjithatë ekipi i BERZH-it nuk u konsiderua si pjesëmarrës aktiv në Zgjidhjen e Problemit, IPAM-i e gjykoi thelbësor ndërveprimin e vazhdueshëm me të, duke qenë se ekipi ka punuar me Klientin për të identifikuar zgjidhjen ndaj shqetësimeve të parashtruara dhe kanë siguruar bashkërisht fondet për zbatimin e saj.

Në qershor të vitit 2023, IPAM-i punësoi një lehtësues vendas nga Shqipëria për të punuar së bashku me ekipin e IPAM-it për të mbështetur Palët gjatë zbatimit të zgjidhjes deri në trajtimin e plotë të problematikave të përfshira në Kërkesë. Lehtësuesi dygjuhësh ka njohuri të mira për kontekstin rajonal dhe kulturën vendase të zonës ku Projekti operon.

[Nisma për Zgjidhjen e Problemit](#) u ndërmor nga IPAM-i në korrik të 2023-shit dhe fokusohej te siguri se zgjidhja teknike e propozuar nga Klienti do të trajtojë nevojat e Kërkuesve lidhur me aksesin e këmbësorëve dhe automjeteve, që do të zëvendësojë kalimin në nivel që komuniteti përdor aktualisht. Gjithashtu, Kërkuesit kanë kërkuar t'u garantohet se kalimi aktual në nivel do të qëndrojë i hapur deri në vendosjen në funksion të zgjidhjes teknike. Nga ana tjetër, Klienti i ka kërkuar komunitetit që të lejojë vijimin e punimeve ndërtimore.

Më 26 korrik 2023, IPAM-i mbajti një takim të përbashkët me Palët në Bërxullë, ku Klienti u paraqiti Kërkuesve zgjidhjen teknike dhe e përshtati atë në përputhje me komentet e tyre. Gjithashtu, Palët ranë dakord që të silleshin me respekt gjatë periudhës së zbatimit. Gjatë takimit, Palët nënshkruan Marrëveshjen, që do të mbahet konfidenciale sipas kërkesës së Palëve. Roli i IPAM-it është të monitorojë zbatimin e saj.

3. MONITORIMI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

Sipas pikës 2.5 a) të Politikës së Llogaridhënies për Projektin, IPAM-i do të monitorojë zbatimin e marrëveshjeve të dakorduara ndërmjet Palëve nëpërmjet Zgjidhjes së Problemit dhe do të nxjerrë Raportet vjetore të Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit për të përshkruar aktivitetet e monitorimit në vazhdimësi.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Zgjidhjes së Problemit më 26 korrik 2023, IPAM-i e transferoi Rastin në fazën e Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit. Ky dokument është Raporti i parë i Monitorimit, që mbulon periudhën nga muaji gusht 2023 në janar 2024.

3.1. VEPRIMTARITË E MONITORIMIT

Nga korriku i 2023-shit, IPAM-i ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të gjitha Palët, duke lehtësuar rrjedhën e informacionit dhe përditësimin e tyre lidhur me ndryshimet e qasjes, nëpërmjet e-mail-it, takimeve virtuale dhe atyre ballë për ballë nga lehtësuesi i IPAM-it me Palët në Shqipëri.

Ekipi i IPAM-it në Londër ka mbajtur takime *online* me Hekurudhën Shqiptare më 15 dhe 28 shtator 2023 dhe më 10 janar 2024, me Kërkuesit më 22 shtator, 20 nëntor 2023 dhe më 18 janar 2024, si dhe me ekipin e Projektit të BERZH-it më 26 shtator, 11 tetor 2023 dhe 9 janar 2024.

Lehtësuesi i IPAM-it u takua nga afër me Palët vendase (Kërkuesit, Bashkia Vorë, Hekurudha Shqiptare dhe Kontraktori) më 8 shtator, 20 shtator, 5 tetor dhe 14 dhjetor 2023. Objektivi i këtyre takimeve ishte ndarja e përditësimeve për Projektin me Kërkuesit lidhur me ndryshimet në qasjen e shpronësimit për ndërtimin e rrugës ndihmëse dhe për t'u siguruar që sugjerimet e bëra nga Kërkuesit lidhur me zgjerimin e nënkalimit ekzistues dhe ndërtimin e një nënkalimi të ri janë marrë në konsideratë në mënyrë të kujdesshme nga Klienti dhe Kontraktori.

3.2. STATUSI I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Afati fillestar për përfundimin e zgjidhjes teknike ishte muaji dhjetor 2023, megjithatë, në fillim të muajit shtator 2023, Klienti konstatoi se nevojitej blerja e tokës për ndërtimin e rrugës ndihmëse. Duke qenë se ky proces përfshin një sërë hapash administrativë, afati fillestar për përfundimin e zgjidhjes teknike nuk është respektuar.

Gjatë komunikimit ndërmjet IPAM-it dhe Kërkuesve, këta të fundit ndanë frustrimin e tyre për vonesën e hasur dhe për faktin se nuk po shihnin ecuri konkrete në terren. Me qëllim ndarjen e përditësimeve për statusin e procesit të blerjes së tokës, në nëntor të 2023-shit, IPAM-i krijoi një fletushkë informuese për anëtarët e komunitetit ku shpjegonte vonesat dhe i njoftonte ata për shtyrjen e afatit. Komunitetit iu shpërndanë kopje të fletushkës falë ndihmës së Përfaqësuesit të Kërkuesve.

Komuniteti i Bërxullës e vlerësoi informacionin e mundësuar dhe shprehu mirëkuptim për vonesat si dhe për nevojën e ndjekjes së procesit të rregullt. Anëtarët e komunitetit mbetën veçanërisht të kënaqur kur mësuan për ndërmarrjen e hapave për shmangien e konfliktit ndërmjet banorëve të zonës në të ardhmen.

Në marrëveshje me Bashkinë Vorë, Hekurudha Shqiptare angazhohet të kryejë shpronësimin e parcelave të ndikuara nga rruga dytësore, në përputhje me kërkesat e performancës të BERZH-it. Pasi procesi i blerjes së tokës të ketë përfunduar, do të fillojnë punimet për ndërtimin e rrugës ndihmëse dhe nënkalimit shtesë, që aktualisht janë planifikuar për verën e vitit 2024. Krahas kësaj, Hekurudha Shqiptare ka ritheksuar angazhimin për mbajtjen hapur të kalimit aktual në nivel deri sa rruga e re ndihmëse dhe nënkalimi të jenë ndërtuar.

4. PËRFUNDIMI

Gjatë periudhës së parë të monitorimit (gusht 2023 - janar 2024), IPAM-i komunikoi me Palët për shkëmbimin e informacionit dhe për të kuptuar sfidat në lidhje me zbatimin e zgjidhjes teknike. Për shkak të rëndësisë së ndjekjes së procesit të rregullt, afati për përfundimin e veprimeve të dakorduara është shtyrë në dhjetor 2024.

Versioni paraprak i Raportit u shpërnda me Palët dhe IPAM-i mori në konsideratë komentet e tyre gjatë finalizimit të tij. Raporti i është dorëzuar për arsye informacioni Bordit Drejtues të BERZH-it dhe Kryetari

dhe Palët janë njoftuar për përfshirjen e tij në dosjen virtuale të [Rastit 2023/02](#) në gjuhën angleze dhe shqipe.

IPAM-i do të vijojë të monitorojë zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Problemit deri në përmbushjen efektive të të gjitha angazhimeve të ndërmarra nga Palët. Raporti i dytë i Monitorimit të Zgjidhjes së Problemit do të mbulojë periudhën shkurt - korrik 2024 dhe pritet të dalë në muajin gusht 2024.